



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-040
Prishtinë, më 23, 26 dhe 30 korrik 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 26 DHE 30 KORRIK 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i Kuvendit i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2018.

* * *

Në fillim, kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra, propozoi që rendi i ditës i seancës plenare të plotësohet edhe me dy pika: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”, si dhe për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve.

Në lidhje me propozimin e lartcekur diskutoi deputeti Ilir Deda, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin për plotësimin e rendit të ditës si dhe shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjeve të lartpërmendura.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 61

Kundër ----- 0

Abstenime -----0

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi për plotësimin e rendin e ditës me dy pika dy pikat e propozuara nga kryetarja e Komisionit për Integritime Evropiane.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Ganimete Musliu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Salih Salihu, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi, Fidan Rekalju, Memli Krasniqi, Liburn Aliu, Shqipe Pantina, Teuta Haxhiu, Luljeta Veselaj-Gutaj, Hajdar Beqa dhe Gani Dreshaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Daut Haradinaj nuk i parashtrroi pyetjet e parashtruara për ministrat Bejtush Gashi dhe Shyqiri Bytyqi, pasi që sipas tij çështjet e ngritura në dy pyetjet janë konsumuar.

Deputeti Avdullah Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit "Renovimi i galerisë së arteve në Kullën e Ali Kadriut në Kroin e Vitakut në Mitrovicë. Ministri Kujtim Gashi, iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili në lidhje me planet e kësaj ministrie për blerje të më shumë aparaturave të Rezonancës Magnetike për nevojat e pacientëve. Ministri Uran Ismaili iu përgjigje pyetjes së deputetes.

Deputetja Doruntinë Maloku-Kastrati i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj në lidhje me përfundimin e punimeve për zgjerimin e rrugës magjistrale Podujevë - Prishtinë. Ministri Pal Lekaj iu përgjigje pyetjes së deputetes.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për fillimin e punimeve për rregullimin e rrugës në rajonin e Hasit. Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me pajisjet e shkollave me laboratore dhe pajisje tjera për hulumtime e punë shkencore. Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetës.

Deputeti Xhelal Sveçla i parashtrroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj, në lidhje me verimet e ndërmarrja nga Kryeministri pas kthimit në vendin e punës të Drejtorit të Prokurimit të z. Nexhat Krasniqi. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me zbatimin e Vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave të zyrtarëve të lartë qeveritar.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me masat e ndërmarra nga kjo ministri pas raportimeve në media për dyshimet e cilësisë së disa punimeve shkencore në Konferencën “Java e Shkencës 2018”

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetës.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me mos nxjerrjen e deritanishme të një ligji të ri për zgjidhjen e kolezionit të ligjeve me vendet tjera në fushën e të drejtës ndërkombëtare private.

Ministri Abelard Tahiri nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Fitore Pacolli i parashtrroi pyetje zëvendëskryeministrit & ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në lidhje me dekarimet e tij për hapjen e zyrave diplomatike të Kosovës në Greqi dhe Sllovaki.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetës.

Deputeti Imet Rrahmani i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili në lidhje me vendosjen e Koronarografrit të ri në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me mjekët specialistë të papunë dhe planet e kësaj ministri për punësimin e tyre.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Elmi Reçica i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për realizimin e projektit për kyçje të Ferizajt në Autostradën “Arbën Xhaferi”.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i parashtrroi pyetje Kryeministrit Ramush Haradinaj, në lidhje me punën e Grupit Punues për hartimin e draft-Statutit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje Kryeministrit Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Kryeministri për themelimin e komunës në Zhegër, sipas vendimit të Qeverisë të vitit 2013.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Sami Kurteshi e parashtrroi një pyetje të mëhershme të bërë për zëvendëskryeministrin & ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

* * *

Në vazhdim, kryetari propozoi që për shkak të mungesës së kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar me shqyrtimin e projektligjeve, të vazhdohet me pikën e rendit të ditës - Debat parlamentar për dialogun me Serbinë.

Lidhur me propozimin e kryetarit, deputetja Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së si propozues të debatit parlamentar, propozoi që debati të zhvillohet një ditë tjetër.

Kryetari e ndërpreu seancën në orën 17:00, për të vazhduar më 26 korrik 2018, në orën 10:00.

* * *

E enjte, më 26 korrik 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetari i Kuvendit.

Në fillim, kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi propozoi që rendi i ditës i seancës plenare të plotësohet me pikën: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +”, Programin e Unionit për arsim, trajnim, rini dhe sport.

Kryetari i njoftoi deputetët edhe me dy propozime tjera për plotësimin e rendit të ditës: 1. Propozimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për Shqyrtimin e Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale dhe 2. Propozimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për shërbime postare.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 6.

Kuvendi me shumicë votash e plotësoi rendin e ditës me pikën: - Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +”, Programin e Unionit për arsim, trajnim, rini dhe sport.

Ndërsa, për dy propozimet tjera nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Pasta, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës së në vijim:

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, diskutuan deputetët: Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit funksional; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës socialdemokrate dhe Allbert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim këtë projektligj dhe në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, votimi u shty për seancën e radhës.

Për shkak të mospjesëmarrjes së deputeteëve në procedurën e votimit pati diskutime se si të vazhdohet më tutje me seancën, kryetari i ftoi në një takim Kryesinë e Kuvendit dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Pas mbledhjes së Kryesisë, kryetari i njoftoi deputetë se do të vazhdohet me pikat e rendit të ditës dhe se do të votohet deri në dy herë për një pikë, nëse edhe atëherë nuk ka kuorum pika shtyhet për seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët” dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”, diskutoi deputetja: Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit funksional dhe në emër të GP të PDK-së, diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim këtë projektligj dhe në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, votimi u shty për seancën e radhës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi

Kryetari i njoftoi deputetët se për pikat e rendit të ditës 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 janë kryer diskutimet, por për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje, votimi i tyre shtyhet për senacën e radhës.

Ai procedoi me pikën e radhës:

11. Debat parlamentar për dialogun me Serbinë

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate ka parshtruar kërkesë për debat parlamentar për dialogon me Serbinë.

Në vazhdim ai e ftoi deputetin Visar Ymeri, që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Visar Ymeri, në emër të GP të Partisë Socialdemokrate e paraqiti dhe e arsyetoi në kërkesën për debat parlamentar. Diskutimi i deputetit Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Për dialogun me Serbinë, diskutuan deputetët: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dukagjin Gorani, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Sllavko Simiq, në emër të GP të Listës serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s, Adem Mikullovc, Ilir Deda, Safete Hadërgjonaj, Saranda Bogujevci, Blerim Kuçi, Aida Dërguti, Zafir Berisha dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët se ka ndërruar jetë veprimtari i dalluar i çështje kombëtare, z. Adem Demaçi. Kuvendi mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për veprën dhe jetën e tij.

Pastaj, kryesuesi në konsultim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare i ndërpreu punimet e seancë në orën 18:10 minuta.

* * *

E hënë, më 30 korrik 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Aida Dërguti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryesuesi procedoi me vazhdimin e diskutimeve të debatit parlamentar për dialogun me Serbinë

Në vazhdimin e debatit, diskutuan deputetët: Haxhi Avdyli, Andin Hoti, Liburn Aliu, Dardan Molliqaj, Vjosa Osmani, Time Kadrijaj, Milaim Zeka, Korab Sejdiu, Blerta Deliu-Kodra, Albin Kurti, Gani Dreshaj, Anton Quni, Nezir Çoçaj, Rexhep Selimi, Driton Çausi, Shkumbin Demaliaj, Zafir Berisha, Fatmire Kollçaku, Bilall Sherifi, Besa Gaxherri, Xhevahire Izmaku, Albulena Haxhiu, Naser Rugova, Ilir Deda, Sala Berisha-Shala, Ismajl Kurteshi, Rasim Selmanaj, Lumir Abdixhiku, Muharrem Nitaj, Zenun Pajaziti, Sami

Kurteshi, Ismet Beqiri, Elmi Reçica, Arbërie Nagavci, Daut Haradinaj, Driton Selmanaj, Bekim Haxhiu, Xhelal Sveçla, Teuta Haxhiu, Doruntinë Maloku-Kastrati, Arbër Rexhaj, Armend Zemaj, Ali Lajçi, Shemsi Syla, Ahmet Isufi, Lirije Kajtazi, Drita Millaku, nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala dhe Glauk Konjufca, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e ftoi propozuesin e debatit parlamentar ta paraqesë Propozim-rezolutën e propozuar.

Deputeti Visar Ymeri propozoi të harmonizohen qëndrimet e grupeve parlamentare dhe të nxirret një rezolutë me pajtimin e të gjitha grupeve parlamentare. Diskutimi i plotë i deputetit Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Kryesuesi, Xhavit Haliti tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje procedimi i Propozim-rezolutës shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi i mbylli punimet e Seancës plenare më 30 korrik 2018, në orën 20:10 minuta.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur Sesionin pranveror për vitin 2018.

Kryetari i Kuvendit:
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*